



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I ANKESAVE DHE MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN**

Nr. 472 Prot.

Tiranë, më 11 . 02 .2026

NJOFTIM ME SHPALLJE

TË VENDIMIT NR. 757/8 PROT., DATË 20.11.2025 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, “PËR ARKIVIMIN PAS VERIFIKIMIT TË ANKESËS SË PARAQITUR NGA SHTETASJA SUADA POCESTA, LIDHUR ME DISA NGA PRETENDIMET E NGRITURA NDAJ GJYQTARES M.F DHE PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT PA NJË VENDIM PËRFUNDIMTAR PËR PRETENDIMET NDAJ GJYQTARIT B.M”

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesat e paraqitura nga znj. Suada Pocesta, me nr. 4338 prot., datë 09.12.2021, në të cilën ngrihen pretendime ndaj veprimtarisë gjyqësore të magistratëve M.F dhe B.M, me detyrë gjyqtarë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Elbasan, në kohën e kryerjes së shkeljes së pretenduar dhe me vendimin nr. 757/8 prot., datë 20.11.2025 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për arkivimin pas verifikimit të ankesës së paraqitur nga shtetasja Suada Pocesta, lidhur me disa nga pretendimet e ngritura ndaj gjyqtarës M.F dhe përfundimin e procedurës së verifikimit pa një vendim përfundimtar për pretendimet ndaj gjyqtarit B.M”, bazuar në nenin 122, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar si dhe në nenin 95 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendimi duhet t’i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Inspektori i Lartë të Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Elbasan, sipas adresës së lënë nga ankuesi: Lagjja “Luigj Gurakuqi”, Elbasan;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

